

## **Ndërtimi i Instrumenteve Monitoruese për Institucionet e Zbatimit të Ligjit dhe Gjyqësorin në Vendet e Ballkanit Përendimor**

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) është duke zbatuar një projekt me titull “Ndërtimi i instrumenteve monitoruese për institucionet e zbatimit të ligjit dhe gjyqësorin në vendet e Ballkanit Përendimor”. Projekti parashikohet që të zgjasë deri në dhjetor të vitit 2010. UNODC ndihmohet nga disa partnerë në zbatimin e këtij projekti, siç janë HEUNI, Transcrime, ICMPD dhe Regional Anti-corruption Initiative for South-East Europe (RAI). Projekti financohet nga BE në bazë të programit CARDS 2006.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të forcojë luftën ndaj krimit dhe korrupsionit në vendet e Ballkanit Përendimor, duke sjellë mekanizmat statistikore kombëtarë ekzistues në institucionet e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme në përputhje me *acquis* e BE, standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare relevante. Institucionet shqiptare të përfshira në projekt, përveç Prokurorisë, janë Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Jashtme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe INSTAT.

Projekti parashikon një numër të caktuar aktiviteteve siç janë studim dhe vlerësim paraprak i situatës në vendet partnere, përfshirë dhe Shqipërinë, misione studimore në vendet partnere dhe trajnime të ndryshme për personelin që merret me statistikat në institucionet përkatëse, me qëllim mbështetjen e personelit kryesorë vendimarrës dhe për të siguruar një tablo të qartë të pikave të forta dhe të dobëta të sistemit aktual informativ dhe statistikor për krimin dhe drejtësinë penale.